



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

V E N D I M

Nr.21, datë 07.12.2021

PËR

**“MIRATIMIN E DOKUMENTIT:
RREGULLORE PËR PROCEDURAT E NJOFTIMIT DHE KËSHILLIMIT PUBLIK”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Tomi	Frashëri	Kryetar
Znj.	Edlira	Dvorani	Anëtar
Znj.	Ketrin	Topçiu	Anëtar
Znj.	Xhoana	Lilaj	Anëtar
Z.	Lorenc	Bako	Anëtar

dhe sekretare Znj. Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 07.12.2021, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin Nr. 7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

- ***Mbi miratimin e dokumentit: Rregullore për Procedurat e Njoftimit dhe Këshillimit publik.***

BAZA LIGJORE:

1. Neni 110, Ligji nr. 9918/2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”,
2. Neni 10, Ligji nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”;
3. Ligji nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe këshillimin publik”
4. Ligji nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në RSH”, (Ligji nr.44/2015);

K Ë SH I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor,

- Dokument i përgatitur nga grupi i punës formuar me Urdhër nr.129, datë 09.06.2021, “Rregullore për Procedurat e Njoftimit dhe Këshillimit publik”, me qëllim kryesor zbatimin efektiv dhe transparencë të kompetencave ligjore që burojnë ndër të tjera nga Ligji nr. 9918/2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tyre;
- Relacioni shoqërues i projekt-aktit hartuar nga DJI (Relacioni);
- Projekt-aktin miratues të dokumentit (projektvendimi);

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. AKEP nëpërmjet miratimit të dokumentit “Rregullore për Procedurat e Njoftimit dhe Këshillimit publik”, optimalizon funksionimin proaktiv të AKEP me të gjitha palët e interesuara në fushën e komunikimit publik dhe atë postar. Një detaj tjetër mjaft i rëndësishëm që të përmbushet tërësisht me miratimin e dokumentit në fjalë, mbetet formimi dhe vendosja e rregullave mbi procesin e njoftimit dhe këshillimit publik që ndiqet nga AKEP, përgjatë hartimit/draftimit të dokumenteve rregullatore për sektorin e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, vendimmarrjeve me ndikim të ndjeshëm në tregun e komunikimeve elektronike dhe atë postar, duke pasur parasysh të drejtat e përdoruesve fundorë, përfshirë këtu edhe përdoruesit me aftësi të kufizuara.
2. Këshillimi Publik përbën një ndër praktikatat më të mira ndjekur nga rregullatorët në Bashkimin Evropian dhe në vendet e rajonit. Zhvillimi i procedurave të këshillimit publik para marrjes së vendimeve rregullatore është një marrëdhënie dypalëshe, në të cilën qytetarët dhe sipërmarrësit paraqesin vlerësimet e tyre lidhur me çështjet e përcaktuara nga rregullatori.
3. Këshillimi Publik duhet të jetë i hapur për të gjitha grupet e shoqërisë tek të cilat vendimi rregullator mund të ketë ndikim, duke shërbyer për mbledhje informacioni, sugjerimesh apo qëndrimesh paraprake, si komponent themelor garantues për sa i përket zbatimit të legjislacionit rregullator në fushën e komunikimit elektronik dhe atë postar.

4. Zhvillimi i procesit të Këshillimit Publik, konsiderohet një standard i pazëvendësueshëm, referuar dhe Direktivës (EU) 2018/1972 të Parlamentit dhe Këshillit të Evropës, datë 11 dhjetor 2018, “Për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike”, në të cilin përcaktohet detyrimi i autoriteteve rregullatore që çdo vendimmarrje me ndikim të ndjeshëm në tregun e komunikimeve elektronike, t’i nënshtrohet një periudhe të përshtatshme të këshillimit publik, gjatë së cilës të gjitha palëve të interesuara i jepet mundësia të shprehin pikëpamjet e tyre.
5. Në përmbushje dhe zbatim të parashikimeve ligjore shprehur më lart, AKEP ndërmerr të gjitha masat për të krijuar mundësinë që çdo palë e interesuar të marrë pjesë në procesin e këshillimit publik, ndërkohë që është i detyruar të marrë dhe të vlerësojë mendimin e palëve të interesuara nëpërmjet procesit në fjalë.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e dokumentit të cituar më lart, bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1, të nenit 115 të Ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar, Këshilli Drejtues i AKEP;

V E N D O S I:

1. Të miratojë dokumentin “Rregullore për Procedurat e Njoftimit dhe Këshillimit publik”.
2. Ky Vendim dhe Dokumenti “Rregullore për Procedurat e Njoftimit dhe Këshillimit publik”, të publikohen në faqen e internetit akep.al.
3. Ngarkohen të gjitha strukturat e AKEP që iniciojnë procedura ndër të tjera konform parashikimeve të shprehura në rregulloren e lartpërmendur, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Tomi Frashëri	Edlira Dvorani	Ketrin Topçiu	Xhoana Lilaj	Lorenc Bako



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

RREGULLORE PËR PROCEDURAT E NJOFTIMIT DHE KËSHILLIMIT PUBLIK

(Miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.21, datë 07.12.2021)

Përmbajtja

HYRJE.....	3
QËLLIMI	4
BAZA LIGJORE.....	4
DETYRIMI PËR KESHILLIM PUBLIK.....	5
RREGULLAT E PROCESIT TË NJOFTIMIT & KËSHILLIMIT PUBLIK.....	6
SHQYRTIMI I ANKESAVE.....	9

H Y R J E

Këshillimi publik është nxitja e shprehjes së mendimeve dhe sugjerimeve të palëve të interesuara për përmbajtjen dhe përmirësimin e akteve, nga momenti i bërjes së tyre publike, deri në miratimin përfundimtar.

Një praktikë rregullatore e konsultuar me palët e interesit dhe me gjerë, duke përdorur procesin e këshillimeve publike para marrjes së vendimeve rregullatore, i shërben, së pari, ndërtimit të një marrëdhënie reciproke ndërmjet palëve të interesuara dhe të prekura nga dalja e këtij akti, dhe pozicionon autoritetin rregullator në rolin e duhur në funksion të qëllimit kryesor të përcaktuar në ligjin nr. 9918/2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tyre.

Procesi i konsultimeve publike, ndër të tjera, synon:

- transparencën në zhvillimin e politikave sektoriale dhe rregullatore, si një ndër parimet e rëndësishme në sigurimin e paanësisë, përgjegjësisë dhe besueshmërisë të vendimmarrjeve rregullatore;
- efektshmërinë e procesit të vendimmarrjes;
- përgjegjësinë e organit rregullator ndaj palëve të interesuara.

Këshillimi Publik përbën një ndër praktikatat më të mira ndjekur nga rregullatorët në Bashkimin Evropian dhe në vendet e rajonit. Zhvillimi i procedurave të këshillimit publik para marrjes së vendimeve rregullatore është një marrëdhënie dypalëshe, në të cilën qytetarët dhe sipërmarrësit paraqesin vlerësimet e tyre lidhur me çështjet e përcaktuara nga rregullatori. Këshillimi duhet të jetë i hapur për të gjitha grupet e shoqërisë tek të cilat vendimi rregullator mund të ketë ndikim, duke shërbyer për mbledhje informacioni, sugjerimesh apo qëndrimesh paraprake, si komponent themelor garantues për sa i përket zbatimit të legjislacionit rregullator në fushën e komunikimit elektronik.

Zhvillimi i procesit të Këshillimit Publik, konsiderohet një standard i pazëvendësueshëm, referuar dhe Direktivës (EU) 2018/1972 të Parlamentit dhe Këshillit të Evropës, datë 11 dhjetor 2018, “Për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike”, në të cilin përcaktohet detyrimi i autoriteteve rregullatore që çdo vendimmarrje me ndikim të ndjeshëm në tregun e komunikimeve elektronike, t’i nënshtrohet një periudhe të përshtatshme të këshillimit publik, gjatë së cilës të gjitha palëve të interesuara i jepet mundësia të shprehin pikëpamjet e tyre.

KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

QËLLIMI

Qëllimi i këtij udhëzuesi është informimi dhe vendosja e rregullave mbi procesin e njoftimit dhe këshillimit publik që ndiqet nga AKEP përgjatë hartimit/draftimit të dokumenteve rregullatore për sektorin e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, vendimmarrjeve me ndikim të ndjeshëm në tregun e komunikimeve elektronike dhe atë postar, duke pasur parasysh të drejtat e përdoruesve fundorë, përfshirë këtu edhe përdoruesit me aftësi të kufizuar.

Neni 2

BAZA LIGJORE

Kjo rregullore hartohet në zbatim të:

1. Neni 110, të ligjit nr. 9918/2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (Ligji nr.9918/2008);
2. Neni 10, të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” të cilët parashikojnë detyrimin e AKEP për të marrë dhe vlerësuar mendimet e palëve të interesuara, nëpërmjet këshillimit publik;
3. dispozitave të Ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe këshillimin publik”, i cili përcakton:
 - a. procesin e njoftimit dhe të këshillimit publik të projektligjeve, projekt dokumenteve strategjike, kombëtar dhe vendor, si dhe politikave me interes të lartë publik;
 - b. rregullat procedurale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikbërëse dhe vendimmarrëse nga organet publike;
 - c. ngarkimin e të gjitha organeve publike që, në proceset vendimmarrëse, të zbatojnë rregullat dhe procedurat e njoftimit e të këshillimit publik;
 - d. Kështu, edhe kjo rregullore për njoftimin dhe këshillimin publik për dokumentet rregullatore dhe vendimmarrjet me ndikim të ndjeshëm, që hartohen dhe miratohen nga AKEP, bazohet në rregullat dhe procedurat e parashikuara nga ligji nr.146/2014.
4. Neni 161, “Njoftimi nëpërmjet publikimit elektronik”, i Kodit të Procedurave Administrative (Ligji nr.44/2015).

Kapitulli II DETYRIMI PËR KONSULTIM PUBLIK

Neni 3

Projekt Aktet e përfshira në procesin e këshillimit publik.

Projekt Aktet/Dokumentet që i nënshtrohen procedurave për njoftimin dhe këshillimin publik, sipas nenit 110, të ligjit nr. 9918/2008, dhe nenit 10, të ligjit nr. 46/2015 janë:

1. Projekt Aktet rregullatore, që nxirren në zbatim të ligjit material, apo të akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi, të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar;
2. Vendimet që, në përputhje me dispozitat e ligjit material, parashikojnë detyrime të veçanta për sipërmarrësit, të cilët ushtrojnë veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare.

Neni 4

Zhvillimi i konsultimeve publike

Në kuptim të parashikimeve ligjore, AKEP ndërmerr të gjitha masat për të krijuar mundësinë që çdo palë e interesuar të marrë pjesë në procesin e këshillimit publik. Mënyrat e parashikuara për garantimin e një pjesëmarrje gjithëpërfshirëse në proceset e këshillimit publik janë, si vijon:

1. Procesi i publikimit të dokumenteve që i nënshtrohen këshillimit publik kryhet në mënyrë elektronike në faqen zyrtare online të AKEP, me qëllim sigurimin e një aksesimi më të gjerë në procesin e këshillimit. Në faqen zyrtare *web* të AKEP, ndodhet një platformë elektronike e kontaktit që shërben si një pikë kontakti midis AKEP dhe palëve të interesuara, në të cilën do të publikohen dokumentet për këshillim publik.
2. Përgjatë procedurës së publikimit të dokumenteve dhe zhvillimit të këshillimit publik, AKEP gëzon të drejtën për të zhvilluar seanca dëgjimore, në të cilat ftohen palët e interesuara për të parashtruar mendimet e tyre për dokumentet rregullatorë të propozuar. Nisma për zhvillimin e seancave dëgjimore është tagër i AKEP. Në rast të zhvillimit të një seance dëgjimore AKEP mban procesverbal.

Neni 5

Platforma elektronike për konsultimet publike

1. Në faqen zyrtare online të AKEP, www.akep.al, në një rubrikë të veçantë vendoset platforma elektronik për këshillimet publike. Në këtë rubrikë shfaqen të gjitha projektaktet apo dokumentet rregullatore që i nënshtrohen procesit të këshillimit publik si dhe çdo dokument tjetër shoqërues/shpjegues. AKEP ndërmerr masat e duhura teknike që kjo platformë të jetë e aksesueshme nga të gjithë qytetarët dhe palët e interesuara.
2. Platforma përfshin informacion të detajuar lidhur me:

- a. publikimin e projektaktit;
- b. afatin e këshillimit publik;

- c. adresën në të cilën duhen dorëzuar komentet/pyetjet/vërejtjet/mendimet e palëve të interesuara;
- d. informacion në lidhje me miratimin e aktit përfundimtar.

3. Të gjithë projektaktet që publikohen në këtë platformë janë:

- a. të ndarë në skedarë/dosje të veçanta.
- b. lehtësisht të aksesueshëm dhe të shkarkueshëm nga palët e interesuara, të cilët kanë të drejtën e printimit dhe të ripërdorimit të dokumenteve.

4. Palë të interesuara në procesin e njoftimit e të këshillimit publik konsiderohen:

- a. organet publike;
- b. sipërmarrësit e komunikimeve elektronike dhe ofruesit e shërbimeve postare;
- c. grupet e interesit të sektorit, çdo përdorues, si dhe shoqatat jofitimprurëse që kanë interes për procesin.

Kapitulli III RREGULLAT E PROCESIT TË NJOFTIMIT DHE TE KËSHILLIMIT PUBLIK

Neni 6 **Koordinatori për këshillimin publik**

Për bashkërendimin dhe administrimin e të gjithë procesit të këshillimit publik, AKEP cakton një punonjës, si koordinator të njoftimit dhe këshillimit publik.

Koordinatori për njoftimin dhe këshillimin publik ka detyrat dhe kompetencat e mëposhtme:

1. është përgjegjës për të grumbulluar, sistemuar, përshtatur të gjithë projektaktet/dokumentet rregullatore të iniciuara nga të gjitha strukturat përkatëse organizative të AKEP;
2. ngarkon projektaktet në formatin e duhur, në faqen e internetit;
3. përditëson në mënyrë të vazhdueshme Platformën;
4. kujdeset për zbatimin e afateve të parashikuara në ligjin material.
5. Koordinatori njofton me e-mail personat e kontaktit, të njoftuar sipas rregjistrimit të sipërmarrësit të publikuar nga AKEP.

Neni 7 **Mënyrat e njoftimit dhe të marrjes së komenteve/rekomandimeve**

AKEP do të publikojë dokumentin në platformën elektronike, duke i dhënë mundësinë çdo pale të interesuar të njihet me të dhe të dërgojë komentet/pyetjet/vërejtjet/mendimet, brenda afatit të përcaktuar. Njoftimi për fillimin e procesit të këshillimit publik do t'i njoftohet palëve të interesuara, sipërmarrësve të komunikimeve elektronike dhe postare, përmes:

- a. Shërbimit Postar; dhe/ose,
- b. Postës Elektronike.

Çdo palë e interesuar mund të kryejë një regjistrim në faqen e internetit të AKEP, për të marrë një njoftim/notifikim në momentin që në platformë publikohet një dokument për këshillim publik.

Palët e interesuara referuar pikës 2, të nenit 110 të ligjit nr. 9918/2008, dhe pikës 2, të nenit 10 të ligjit nr. 46/2015, dhënien e komenteve/pyetjeve/vërejtjeve/mendimeve për dokumentin e nxjerrë në këshillim publik, e paraqesin në formë të shkruar pranë zyrës së arkiv-protokollit të AKEP, si dhe nëpërmjet platformës elektronike të AKEP.

Neni 8

Afati për dorëzimin e komenteve dhe rekomandimeve

1. Afati ligjor minimal i përcaktuar për dorëzimin e komenteve/rekomandimeve, në rastin e projektakteve apo dokumenteve rregullatore që i përkasin sektorit të komunikimeve elektronike (pika 2 e nenit 110, dhe pika 3 e nenit 68, të ligjit nr. 9918/2008), **është 30 ditë**. Referuar nenit 56 të Kodit të Procedurave Administrative (ligji nr. 44/2015), ky afat konsiderohet minimalisht **30 ditë kalendarike**.

2. Afati ligjor për procedurat për raste specifike, që i referohen vendimmarrjeve që kanë për objekt përcaktimin e tregut apo analizën e tregjeve të komunikimeve elektronike (sipas nenit 35 të ligjit nr. 9918/2008), do t'i nënshtrohet një procesi këshillimi me afat kohor të përcaktuar **60 ditë kalendarike**.

3. Në rastin e dokumenteve rregullatore dhe vendimeve për sektorin e shërbimeve postare, afatet do të llogariten sipas atyre të përcaktuara në pikën 1, të nenit 15, të ligjit nr. 146/2014, "Për njoftimin dhe këshillimin publik", si më poshtë:

a. Në rastet kur organi publik ndjek procedurën e "njoftimit paraprak", para se të fillojë hartimin e aktit, palët e interesuara duhet të dërgojnë brenda **20 ditëve** rekomandimet dhe komentet. Afati është në ditë pune dhe fillon nga data e njoftimit për procesin e njoftimit paraprak.

b. Në rastin e njoftimeve për procesin e këshillimit publik për projektaktet, afati është **20 ditë pune**, dhe fillon nga data e njoftimit të procesit të këshillimit publik.

c. Afati mund të zgjatet deri në **40 ditë pune** dhe fillon nga momenti i njoftimit të këshillimit publik. Në rast se organi publik vendos të shtyjë afatet, ai duhet të njoftojë palët e interesuara. Afatet si më sipër do të llogariten nga data e njoftimit të procesit të këshillimit.

Koordinatori i procesit të këshillimit, brenda 48 orëve nga momenti i miratimit/zbardhjes së dokumentit/aktit të miratuar për konsultim publik nga Këshilli Drejtues i AKEP, e publikon atë në platformën elektronike.

Neni 9

Pjesëmarrja e palëve të interesuara në seancat dëgjimore

AKEP, në rastet kur e çmon të nevojshme apo kur projektakti ka një rëndësi të veçantë dhe një interes të lartë publik, përveç njoftimit të këshillimit publik, mund të zhvillojë edhe seanca dëgjimore, me pjesëmarrjen e subjekteve apo grupeve të interesit.

Në mënyrë që palët e interesuara të kenë kohë të përgatiten dhe të kenë mundësi të marrin pjesë në seancën dëgjimore, AKEP duhet të bëjë njoftimin për zhvillimin e seancës dëgjimore, jo më pak se 8 ditë kalendarike përpara takimit.

Bashkë me njoftimin për afatin, bashkëngjitet edhe informacioni për vendin, datën dhe orën kur do të zhvillohet takimi, si dhe një kopje e projektaktit që do t'i nënshtrohet këshillimit publik.

Neni 10

Shqyrtimi i mendimeve

Pasi palët e interesuara dërgojnë komentet/pyetjet/vërejtjet/mendimet në mënyrën dhe adresën e përcaktuar nga AKEP, koordinatori për njoftimin dhe këshillimin publik vijon me grumbullimin e tyre në mënyrë të strukturuar dhe transparente.

Komentet/pyetjet/vërejtjet/mendimet shqyrtohen nga struktura përgjegjëse që ka hartuar projektaktin apo dokumentin rregullator dhe që i është nënshtrohet procesit të këshillimit publik, duke garantuar sekretin tregtar dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Më pas, brenda një afati të arsyeshëm, AKEP u përcjell përgjigjet ndaj pyetjeve të parashtruara.

Në fund të procesit të këshillimit, si dhe përpara marrjes së vendimmarrjes së Këshillit Drejtues të AKEP, struktura përgjegjëse për hartimin e projektaktit apo dokumentit rregullator harton një përmbledhje, në të cilën parashtrihen komentet dhe vërejtjet me argumentimin përkatës.

Pas miratimit nga Këshilli Drejtues i AKEP, dokumenti publikohet në faqen *web* dhe më pas i përcillet palëve të interesuara.

Neni 11

Raportet për transparencën në procesin e vendimmarrjes

Krahas zhvillimit të procedurave të njoftimit dhe këshillimit publik, koordinatori i njoftimeve dhe këshillimit publik, harton një raport vjetor i cili përfshin:

- a. numrin e akteve të miratuara nga organi publik gjatë vitit referues;
- b. numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara;
- c. numrin e rekomandimeve e të komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes;
- d. numrin e seancave dëgjimore të organizuara.

Të dhënat e përpunuara mbi proceset e këshillimeve publike, përfshihen në Raportin Vjetor të AKEP.

Kapitulli IV
DISPOZITA TE FUNDIT

Neni12
SHQYRTIMI I ANKESAVE

Në rast se vlerësohet se, AKEP ka cënuar të drejtën për njoftim dhe këshillim publik, si dhe në rast ankesash me objekt mosrespektimin e afateve të parashtruara sipas kësaj rregulloreje, palët e interesuara ndjekin procedurat ankimuese të parashikuara në nenin 21, të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe këshillimin publik”.

Neni13
HYRJA NË FUQI

Kjo Rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit të saj me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP.